



NJOFTIM PËR VENDE TË LIRA PUNE

PËR PERSONEL AKADEMIK ME KOHË TË PLOTË NË FAKULTETIN E SHKENCAVE MJEKËSORE TË UNIVERSITETIT “LUARASI” PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022

Universiteti “Luarasi”, në zbatim të Urdhrit të Rektorit Nr. 1, datë 14.7.2021 “ Për punësimin e personelit akademik me kohë të plotë për vitin akademik 2021 – 2022, shpall njoftimin për konkurim të hapur, për vendin e lirë të punës në Departamentin e Stomatologjisë të Fakultetit të Shkencave Mjekësore:

Përshkrimi i vendit të punës

Personeli akademik me kohë të plotë që do të punësohet do të anagazhohet në mësimdhënie në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Stomatologji”, pranë Departamentit të Stomatologjisë të Fakultetit të Shkencave Mjekësore.

Kritere të përgjithshme që duhet të plotësoj/në kandidati/ët

- Të jetë shtetas shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar
- Të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkuron;
- Të jetë i aftë të garantoj standardin e cilësisë dhe efikasitetin në mësimdhënie.
- Të ketë aftësinë e punës në grup dhe të komunikimit profesional me kolegët dhe studentët;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të Gjykatës për kryerjen e një vepre penale si dhe të mos jetë person nën hetim;
- Të jetë i aftë nga ana shëndetësore;
- Të ketë eksperiencë në punë.

Kriteret bazë:

1. Të jetë diplomuar “Stomatolog” në Universitetin Mjekësor të Tiranës; Fakulteti i Mjekësisë; Dega Stomatologji ose në një universitet të huaj.
2. Duhet të zotërojë të paktën gradën shkencore titullin “Doktor i Shkencave”.
3. Të ketë të paktën 5 vite përvojë akademike ose profesional, brenda ose jashtë vendi.
4. Të përmbushin kriteret, që përcaktohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Dokumentacioni i kërkuar

- 1) Kërkesë me shkrim drejtuar Universitetit “Luarasi”
- 2) Fotokopje të diplomave dhe të certifikatës/ave së notave të noterizuar/a. (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*).
- 3) Dy letra rekomandimi dhe të paktën një nga letrat të jetë nga punëdhënësi / drejtuesi i fundit nëse ka një të tillë;
- 4) Nëse ka përvojë të mëparshme në mësimdhënie, një nga letrat e rekomandimit të jetë nga titullari i IAL;
- 5) Fotokopje të dëshmimeve e kualifikimeve të ndryshme, si dhe të publikimeve e të pjesëmarrjeve në Konferenca Shkencore.
- 6) Fotokopje të kartës së identitetit, ose ndonjë dokumenti tjetër identifikimi;
- 7) Fotokopje të librezës së punës, nëse ka, apo vetëdeklarim punësimi ose vetëdeklarim si i punësuar;
- 8) Fotokopje e noterizuar e dëshmisë së zotërimit të gjuhës së huaj;

Skualifikohen dhe nuk kalojnë në fazën e dytë, thirrjen në intervistë, ata aplikantë të cilët paraqesin dokumenta të pa noterizuara, ose kanë mangësi në dokumentacionin e kërkuar.

Dokumentat duhet të dorëzohen përmes shërbimit postar ose dorazi në adresën:

Universiteti “Luarasi”, Tiranë.

Adresa: Rruga e Elbasanit, Nd. 59, H.1

Njësia Administrative Nr.2, Kodi Postar 1010

Tiranë, Shqipëri

Aplikim për Staf Akademik në Universitetin “Luarasi”

Afati për dorëzimin e dokumentave është deri më **datë 28.08.2021** .

Për më shumë informacion ju lutem kontaktoni:

Zyrën e Burimeve Njerëzore të Universitetit “Luarasi” në adresën:

Email: gersilda.malaj@luarasi-univ.edu.al ose info@luarasi-univ.edu.al

Mob: + 355688030950